

KREU VI: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1. Mbi gjendjen mjedisore të lumenjve në studim

Në pasqyrën 6-1 jepet një vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së ujërave të lumenjve të studjuar duke u mbështetur në parametrat fiziko-kimikë dhe kimikë, duke u mbështetur në klasifikimin e NIVA-s (Bratli, 2000). Për këtë qëllim është njehsuar një vlerë mesatare e klasës së cilësisë duke përdorur formulën 2.1 (§ 2.5). Për rastin e parametrave të përgjithshëm fiziko-kimikë janë marrë parasysh vlerat mesatare të pH, TSS, NO₃-N, NO₂-N, NH₄⁺-N dhe PO₄-P, dhe vlera minimale e DO, ndërsa për metalet e rëndë janë marrë parasysh vlerat maksimale të Fe, Mn, Zn, Cu, Pb, Cd, Ni dhe Cr.

Tabela 6-1: Vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së ujërave mbështetur në vlerat e parametrave fiziko-kimikë dhe ato të metaleve të rëndë/General evaluation of water quality based in values of general parameters and heavy metals (according NIVA's classification: Bratli, 2000)

| Lumi | Stacioni | Vlerësim mbështetur tek | | | |
|-----------|----------|-----------------------------------|-------------------|--------------------------|-------------------------|
| | | Parametrat fiziko-kimikë në ujëra | | Metalet e rëndë në ujëra | |
| | | Klasa | Vlerësimi (Klasa) | Klasa | Vlerësimi (Klasa) |
| Mati | Ma1 | 2.0 | Mirë (II) | 3.3 | Ndotje e theksuar (III) |
| Fani | Ma2 | 2.2 | Mirë (II) | 3.6 | Ndotje e theksuar (III) |
| Mati | Ma3 | 2.3 | Mirë (II) | 3.1 | Ndotje e theksuar (III) |
| Tirana | Is1 | 2.7 | Mirë (II) | 3.7 | Ndotje e theksuar (III) |
| Lana | Is2 | 4.5 | Keq (IV) | 4.4 | Ndotje e rëndë (IV) |
| Ishmi | Is3 | 4.2 | Keq (IV) | 3.6 | Ndotje e theksuar (III) |
| Shkumbini | Sh1 | 2.7 | Mirë (II) | 4.0 | Ndotje e rëndë (IV) |
| | Sh2 | 2.8 | Mirë (II) | 4.0 | Ndotje e rëndë (IV) |
| | Sh3 | 2.7 | Mirë (II) | 3.3 | Ndotje e theksuar (III) |
| Osumi | Se1 | 2.2 | Mirë (II) | 3.4 | Ndotje e theksuar (III) |
| Osumi | Se2 | 2.5 | Mirë (II) | 3.4 | Ndotje e theksuar (III) |
| Gjanica | Se3 | 4.3 | Keq (IV) | 4.1 | Ndotje e rëndë (IV) |
| Semani | Se4 | 3.0 | Mesatar (III) | 3.6 | Ndotje e theksuar (III) |

Në pasqyrën 6-2 bëhet, gjithashtu, vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së sedimenteve të lumenjve të studjuar duke u mbështetur në klasifikimin e NIVA-s (Bratli, 2000), duke përdorur të njëjtën formulë 2.1 (§ 2.5). Si parametra të përgjithshëm janë marrë parasysh vlerat maksimale të Zn, Cu, Pb, Cd, Ni dhe Hg (N=6). Eshtë interesant të vihet në dukje, se ndërsa cilësia e ujërave, është e klasës së tretë (ndotje e theksuar, tabela 3-23), ose në ndonjë rast dhe e klasës së katërt (ndotje e rëndë, pikërisht në stacionet Is2, Is3 dhe Se3), gjendja e sedimenteve në të gjitha stacionet i përket klasës së parë (lehtësisht e ndotur, tabela 3-36). Ndoshta këtu lind nevoja e hartimit të një standardi kombëtar, pasi klasifikimi varet edhe nga vlerat e fonit natyror të këtyre elementeve.

Tabela 6-2: Vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së sedimenteve mbështetur në vlerat e metaleve të rëndë (Bratli, 2000; tab. 2-3)/General evaluation of quality based in maximal levels of heavy metals in sediments (Bratli, 2000; tab. 2-3)

| Lumi | Stacioni | Klasa | Vlerësimi (Klasa) |
|--------------------------|----------|-------|-------------------------|
| Mati, Shkopet | Ma1 | 1.33 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Fani, Rubik | Ma2 | 1.5 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Mati, Milot | Ma3 | 1.7 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Tirana, Brar | Is1 | 1.5 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Lana, Kashar | Is2 | 1.5 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Ishmi, Fushë Krujë | Is3 | 1.33 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Shkumbini, Labinot Fushë | Sh1 | 1.5 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Shkumbini, Paper | Sh2 | 1.5 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Shkumbini, Rrogzhinë | Sh3 | 1.5 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Osumi, Berat | Se1 | 1.33 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Osumi, Ura Vajgurore | Se2 | 1.16 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Gjanica, Fier | Se3 | 1.5 | Lehtësisht i ndotur (I) |
| Semani, Mbrostar | Se4 | 1.33 | Lehtësisht i ndotur (I) |

Është interesant të vihet në dukje varësia e drejtë ndërmjet vlerave të dy grupeve të parametrave. Në veçanti, stacionet me ndotje shumë të larta nga shkarkimet urbane kanë cilësinë më të keqe, qoftë sipas vlerave të parametrave të përgjithshëm, ashtu edhe sipas përmbajtjes së metaleve të rëndë. Kjo tregon se ndotjet e ujërave të lumenjve janë nga burime të njëjta, pikërisht nga shkarkimet urbane.

Mbi 265 lloje diatomes janë gjetur në periftonin e stacioneve të ndryshme të lumenjve, ku rreth vetëm 15 lloje u përkasin rendit të diatomeve centrike, kurse shumica i përkasin rendit të penateve (tab. 5-37 deri 5-43; pasqyrat 5-1 deri 5-13). Rreth 30 lloje janë të pranishme në listën e kuqe evropiane, dhe një lloje, *Caloneis nov. sp.*, mendohet se është lloj i ri. *Achnanthes minutissima*, *Amphora pediculus*, *Cocconeis pediculus*, *Diatoma moniliformis*, *Fragilaria capucina*, *Gomphonema tergestinum* dhe *Nitzschia dissipata* ishin mbizotëruesi në Mat dhe Fan (në gjithë stacionet), në pjesën e sipërme të Tiranës, të Shumbini dhe Osumit. Në këto pjesë të lumenjve është gjetur gjithashtu një ndryshueshmëri e lartë llojore (tab. 5-36). Tek Lana, Ishmi dhe Gjanica struktura e diatomeve mbizotërohej kryesisht nga lloje saprotrofe ose toleruese, si *Nitzschia palea*, *N. incospicua*, *Gomphonema parvulum*, *G. olivaceum*, *Navicula accomoda*, *N. veneta* dhe *N. saprophila*.

Treguesi ushqyes i diatomeve luhetet nga 1.6 (*mesotrof*, në Mat) deri në 3.4 (*politrof*, në Ishëm, Lanë dhe Gjanicë). Vlerat më të larta janë llogaritur për Lanën dhe Ishmin, në rrjedhën e poshtme të Shkumbini (nga Elbasani në Rrogozhinë) dhe Gjanicës, që tregon ndotje të rëndë me origjinë urbane nga qytetet e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit. Vetëm në zonat malore ujërat paraqiten lehtësisht të ndotura si është vërtetuar në lumen e Bushkashit (1.4, *oligo-mesotrof*).

Si **përfundim** mund të pohojmë se parametrat më kritikë të cilësisë së ujërave të lumenjve të studjuar janë:

- 1) Përmbajtja e shumë e lartë **lëndëve të ngurta pezull**, si rrjedhojë e erozionit të vrullshëm në pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve.
- 2) Vlerat e larta të **azotit** thuajse në të gjitha stacionet e lumenjve, si pasojë e shkarkimeve të lëngëta urbane, sidomos në afërsi të qyteteve të mëdha si Tirana dhe Fieri.
- 3) Vlerat **minimale të oksigjenit të tretur** dhe të përqindjes së oksigjenit në disa stacione, sidomos në Lanë, Ishëm dhe Gjanicë, për shkak të shkarkimeve të ujërave të zeza të qyteteve në afërsi të këtyre stacioneve.

4) Përbërja e popullatave të diatomeve tregon ndotje mesatare organike dhe inorganike (β -mesosaprobe) në Mat, në rrjedhjen e sipërme të lumit të Tiranës, Shkumbin dhe Osum. Lana dhe Ishmi, rrjedhja e poshtme e Shkumbinit dhe Gjanica, përfshihen nga gjendja α -mezo-saprobe në poli-saprobe.

5) Për Ishmin, Tiranën dhe Lanën duhen marrë sa më shpejt që të jetë e mundur masa të forta mbrojtëse për përmirësimin e cilësisë së ujërave.

6) Monitorimi i rregullt i cilësisë së ujërave duhet të jetë me mjaft përparësi për të rritur informacionin e nevojshëm dhe ndërgjegjen publike për mbrotjen e ekosistemeve ujorë.

6.2. Mbi gjendjen mjedisore të ujërave sipërfaqësore në Shqipëri

Cilësia e ujërave natyrorë shqiptarë dhe ndikimi i njeriut është diskutuar prej nesh në një publikim përmbledhës (Çullaj *et al.*, 2005). Vlerësimi i cilësisë së ujërave në Shqipëri ka qënë përgjithësisht i çregullt, shpesh i kufizuar në parametra fiziko-kimikë të thjeshtë, si mineralizimi, temperatura, pH, përcjellshmëria etj. Vlerësimi i ushqyesve (azotit dhe fosforit) dhe i ndotësve industrialë, bujqësorë ose urbanë është kryer jo rregullisht. Tjetër mangësi është mundësia e kufizuar e shkëmbimit të informacionit, sidomos në vitet e fundit, dhe shkalla e ulët e besueshmërisë së të dhënave.

Nisur nga sasia dhe cilësia e shkarkimeve ndotëse, në gjendjen mjedisore në Shqipëri mund të veçohen dy periudha të ndryshme.

Para vitit 1991, ndotja ishte kryesisht industriale dhe bujqësore. Burimi kryesor i ndotjes vinte kryesisht nga përdorimi i teknologjive të vjetra në industri dhe sasia e tepruar e plehrave dhe pesticideve në bujqësi. Burim ndotje ishin ndërmarrjet industriale që përdornin lëndë helmuese, si p.sh. lëndë organike ose inorganike të arsenikut, kromit, merkurit, si dhe pesticidet dhe stoqet e lëndëve kimike. Gjatë asaj kohe, prej industrisë shkarkoheshin drejtpërdrejt në lumenj rreth 250×10^6 m³/vit mbeturina të lëngëta. Meqë rreth 65% e popullsisë jetonte e

shpërndarë nëpër fshatra ndotja urbane mund të konsiderohej e pakët, vetëm në zona shumë të kufizuara.

Nga minierat, nga shkërrja dhe pasurimi i bakrit çdo vit prodhoheshin mbi 10^6 tonë mbetje të ngurta. Aktiviteti mineral më i madh ishte në pellgun e Matit. Çdo vit nxirrej rreth $0.7 \cdot 10^6$ t bakër, dhe mbi $0.65 \cdot 10^6$ t sterile (mineral i varfër) hidhej në brigjet e Fanit, Drinit dhe Matit (Shehu & Malja, 1998). Për më tej, rreth 10^6 m³ ujëra shkarkoheshin çdo vit nga pasurimi mineral dhe metalurgjitë. Në këto ujëra janë gjetur mbi 30 lëndë ndotëse, si p.sh. metale të rëndë (Pb, Zn, Fe, Cu, Cr), shpesh në përqëndrime 7-10 herë më të larta se normat e lejuara. Në sedimentet e deltës së Matit përqëndrimet e metaleve të rënda ishin më të larta se ato të detit Adriatik (tabela 1-4). Lëndët e ngurta pezull (TSS) në lumenj arrinin mesatarisht deri në 1.65 t s^{-1} , që i përket sasisë prej $53.25 \cdot 10^6$ t/vit, të cilat transportohen në det (Kabo, 1990-91), ku pjesa më e madhe i përket mbeturinave të ngurta industriale.

Pas vitit 1991, shumë prej aktiviteteve industriale u mbyllën dhe përdorimi i kimikateve në bujqësi u pakësua dukshëm. Lëvizja masive e popullsisë drejt qendrave të mëdha të Ultësirës Perëndimore, si në Tiranë, Durrës etj. bëri që ndotja urbane të rritet mjaft. Kjo vihet re menjëherë, nga vështrimi me sy të lirë i saprobisë në afërsi të qyteteve dhe zonave të tjera të banuara. Këtë e mbështesin gjithë rezultatet e këtij studimi të diskutuara më sipër, sidomos vlera e lartë e ushqyeseve (azotit dhe fosforit, tab. 5-15; fig. 5-16 deri 5-20 dhe 5-22), si dhe vlera e lartë e treguesit ushqyes (tab. 5-36; fig. 5-42). Sipas këtyre të dhënave në përgjithësi ujërat e Ultësirës Bregdetare janë eupolitrofe ose politrofe (Lana dhe Ishmi), klasa mjaft të larta që tregojnë ndotje të rëndë. Në përgjithësi ujëra të tilla kanë vlerë përdorimi mjaft të ulët dhe paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut.

Të dhënat e cilësisë së ujërave gjatë viteve 1997-98 janë publikuar në Raportin e Gjendjes Mjedisore (AKM/NEA, 1997-98) nga ish Agjencia Kombëtare e Mjedisit (f. 54-61). Vlerësimi i cilësisë së ujërave në lumenj është bërë mbështetur në klasifikimin e UNECE, nisur përqëndrimet e fosforit të përgjithshëm, nitrateve, oksigjenit, BOD₅,

COD dhe amoniumit. Prej tyre arrihet në përfundimin se, 'mbi 80% e ujërave të lumenjve në Shqipëri kanë përgjithësisht cilësi të lartë'. Veçanërisht, në 90% të lumenjve përmbajtja e COD luan brenda 0,2 dhe 3,6 mg O₂/l, dhe BOD₅ brenda 0,4 dhe 4,0 mg O₂/l. Vlerat e oksigjenit ishin poshtë 9 mg/l vetëm në 5% të rasteve. Me përjashtim të Ishmit dhe Semanit, ushqyesit tek të gjithë lumenjtë e tjerë ishin të ulët. Pra nga raportet shtetërore (KMM/CEP, 1995-1996; AKM/NEA, 1997-98) arrihet në përfundimin se cilësia e ujërave të lumenjve shqiptarë është përgjithësisht e mirë, me përjashtim të Ishmit dhe Gjanicës.

E parë në këndvështrim territorial raportet shtetërore kanë plotësisht të drejtë. Edhe nga ky studim mund të deduktohet se një pjesë e mirë (ndoshta mbi 2/3) e territorit shqiptar është në gjendje të mirë. Ne mund të pohojmë se ujërat në pjesën e sipërme të lumenjve janë me cilësi oligomezotrofe, shumë e pranueshme dhe e pa rrezikshme për shëndetin e njeriut. Edhe në ato zona ku dyshohet për ndotje për metalet e rëndë, si në Fan, Mat dhe Shkumbin, fatmirësisht u vërejt se vlerat e tyre janë zvogëluar ndjeshëm. Kjo do të thotë se ndërprerja e aktivitetit mineral dhe përpunues në këta 15 vjetë të tranzicionit ka ndihmuar në vetëpastrimin dhe ndërprerjen e ndotjes. Megjithatë, pjesët e ndotura të lumenjve përkrijnë me zonën më të populluar të vendit. Po t'i hedhim një sy hartës në figurën 1-2, të botuar nga INSTAT (2004) vëmë re se në zonën bregdetare është përqendruar thuajse popullsia më e madhe e Shqipërisë. Gjithë aktiviteti bujqësor, industrial, turistik etj. është i përqendruar në këtë zonë. Edhe kërkesa për përdorimin e burimeve ujore, si për vaditje, blegtari, industri ushqimore etj. Është, gjithashtu, më e madhe në këtë zonë. Mos të harrojmë se Ultësira Perëndimore është drejtpërdrejt e lidhur me bregdetin dhe lagunat bregdetare, që janë nga pikat më të forta të natyrës shqiptare, për zhvillimin e turizmit dhe për biodiversitetin e lartë. Për këtë, edhe shqetësimi dhe ndërjegjësimi për masa parandaluese duhet të dalë në plan të parë.

Këto pohime i thekson edhe raporti i fundit i UNEP-it (2000), se 'burimet ujore në Shqipëri janë të bollshme por të kërcënuara seriozisht'. Gjithashtu, po qe se merren parasysh kufijtë e BE-së (BMZ, 1995; tab. 2-2), ose ata të vendeve të veçanta, si p.sh. Norvegjisë (Bratli, 2000; tab. 2-3), të Gjermanisë ose Zvicrës etj., cilësia e ujërave

përkeqësohet dukshëm tek lumenjtë që përshkojnë Ultësirën Perëndimore Adriatike.

Si përfundim i gjithë këtij studimi dhe i të dhënave të tjera po paraqesim më poshtë disa nga shkaqet që ndërthuren sëbashku në uljen e cilësisë së ujërave në Shqipëri:

(i) **Ndotje nga shkarkimet urbane:** Në Shqipëri nuk ka ende asnjë impiant përpunimi/pastrimi për shkarkimet e lëngëta urbane. Ujërat e zeza derdhen drejtpërdrejt në lumenj dhe shkojnë drejt detit. Për rrjedhojë, poshtë qyteteve dhe fshatrave vihen re sasi e madhe bakteresh fekale. Në lumin e Tiranës janë gjetur $1.2 \times 10^8/100$ ml *E. coli* cfu (*colony forming units/njësi koloni formuese*), $1.1 \times 10^7/100$ ml në Shkumbin dhe $1.1 \times 10^6/100$ ml në Kir (në Bunë). Sipas raportit të METAP, kufiri i sipërm i baktereve duhet të jetë $10^3/100$ ml (METAP, 1997). Gjithashtu, edhe **mbeturinat e ngurta** vazhdojnë të hidhen në mënyrë të pakujdesëshme përgjatë brigjeve të lumenjve.

(ii) **Ndotje nga shkarkimet e ngurta dhe të lëngëta industriale:** Këto mund të vijnë nga fabrikat e industrisë së lehtë dhe ushqimore, fabrikat e çimentos, të përpunimit të lëkurëve, të qeramikës, të tekstileve, minierat, metalurgjia, nxjerrje dhe përpunimi i naftës dhe gazit, dhe përpunimi i drurit (UNEP, 2000). Shumë nga këto aktivitete janë të përqëndruara në pellgjet e Ishmit (Tiranë dhe Lanë), Shkumbinit (pjesa e poshtme), Semanit (Osum dhe Gjanicë) dhe Matit (Fan).

(iii) **Ndotje nga shkarkimet e ngurta, kryesisht nga minierat dhe ndërmarrjet pasuruese:** Këto janë ato të bakrit, kromit dhe hekur-nikelit. Vendshkarkimet e tyre gjenden shpesh në brigjet e lumenjve. Sasia e tyre mund të jetë deri në 12.5×10^6 tonë, ku rreth 9×10^6 e të cilave janë sterile të mineralit të bakrit me përmbajtje bakri 0.15 deri në 0.20%. Megjithëse aktiviteti mineralar, metalurgjik dhe kimik është pakësuar mbas viteve 90-të, përsëri grumbullimet masive të këtyre shkarkimeve përbëjnë rrezik mjedisor dhe për shëndetin e njeriut. Më

problem në këtë drejtim ka qenë lumi Mat (veçanërisht degët e tij, Fan i Madh dhe Fan i Vogël) dhe pjesa e poshtme e Shkumbinit.

(iv) **Ndotja nga industria e naftës:** Industria e naftës (nxjerrjes dhe përpunimit) mbetet ende ndër burimet kryesore të ndotjes së ujërave të brendshme dhe bregdetare, më e theksuar kjo për lumenjtë Seman dhe Vjosë. Këta ujëra përmbajnë shumë lëndë të rrezikshme; p.sh. COD luhatet nga 131 deri 157 mg/l, BOD rreth 42 mg/l, benzeni nga 0.36 deri 0.72 mg/l tolueni nga 0.76 deri 1.51 mg/l dhe fenolet midis 2.62 deri 3.64 mg/l. Mërkuri në sedimentet detare është gjetur në nivele midis 0.50 dhe 0.77 mg/kg (Çullaj *et al.*, 2000).

(v) **Dëmtimi i mbulesës bimore dhe erozioni:** Shtrirja e tejskajshme e bujqësisë në dhjetëvjeçarët e fundshekullit të kaluar, me shpyllëzime dhe tarracime për toka bujqësore deri edhe në shpatet më të brishta kodrinore, shpesh dhe malore, ishin hapat e para në dëmtimin e mbulesës bimore natyrore. Me kthesën e ekonomisë shqiptare drejt ekonomisë së tregut gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, periudhë e ashtuquajtur e 'tranzicionit', në gjendjen e brishtë të ekonomisë shqiptare nuk u mund të parandalohesh shfrytëzimi i tepruar i pyjeve, duke thelluar më tej problemin madhor të ditëve të sotme, **erozionin**.

Si rrjedhojë e dëmtimit të mbulesës bimore aftësia ujëmbajtëse në tokë dhe ujërat nëntokësore pakësohen mjaft (Michael & Meyer, 2001). Nga ana tjetër, ujërat sipërfaqësore pësojnë luhatje të mëdha, që shoqërohet shpesh edhe me dalje nga shtrati dhe me përmytje, e theksuar kjo në dhjetëvjeçarin e fundit në lumenjtë e Drinit, Shkumbinit dhe Ishmit. Prej erozionit ndryshon edhe përbërja kimike e ujërave, rritet përmbajtja minerale etj., gjë që nxit etrofikimin e ujërave të lumenjve dhe të detit.

(vi) **Ndotja e ajrit:** Ndikon tërthorazi në cilësinë e ujërave dhe të vetë shëndetit të njeriut. Burimet kryesore të **ndotjes së ajrit në Shqipëri** kanë qenë historikisht industria e shkrirjes së kromit, ajo e bakrit, metalurgjia e gizës dhe e çelikut, si dhe termocentralet. Pas vitit 1992,

shumë prej këtyre industrive janë mbyllur. Megjithëse nuk ka të dhëna për lëshimet e gazeve, nuk është e vështirë të kuptohet se cilësia e ajrit në disa zona është përmirësuar. Burime kryesore të ndotjes së ajrit sot janë nxjerrja dhe përpunimi i naftës, transporti, ngrohja shtëpiake, prodhimi i çimentos, si dhe djegia e pakontrolluar e mbeturinave urbane.

Transporti rrugor është shkaktar i rëndësishëm i ndotjes së ajrit. Në vitin 1989, në Shqipëri kishte rreth 2'000 makina. Deri në vitin 2004 ky numër u rrit mbi 150'000 vetëm automjete të vogla në mbarë vendin. Makinat, përgjithësisht, janë të vjetra dhe përdorin naftë ose benzinë me plumb. Kjo rritje e shpejtë mund të çojë ndër të tjera në shtimin e NO_x, SO₂, CO, të pluhurit dhe të hidrokarbureve. Më shqetësuese kjo gjendje është në zona e populluara dendur, sidomos brenda dhe rreth qyteteve të mëdha, si: Tirana, Durrësi, Shkodra, Vlora, Fieri etj.

(vii) Shumë ujë nga lumenjtë përdoret për ujitje, peshkim, ujë i pijshëm i puseve në zonat suburbane ose puset e ndërmarjeve ushqimore. Vlen të kujtojmë që laguna e Patokut, një zonë e rëndësishme me biodiversitet të lartë për florën dhe faunën, sidomos për peshqit dhe zogjtë e ujrave, ndodhet shumë afër deltës së Ishmit. Nga sa është diskutuar, rekomandojmë fort se nevojiten masa të menjëhershme për ripërtëritjen e cilësisë së ujërave të Ishmit dhe degëve të tij, sa më shpejt të jetë e mundur.

6.3. Vlerësime përfundimtare

Nga të dhënat e këtij studimi duket qartë së Ultësira Bregdetare Adriatike është mjaft e kërcënuar. Në këtë zonë edhe kërkesa për ujë është e madhe për shkak të popullsisë së dendur dhe aktivitetit të vrullshëm, si në bujqësi, blegtori, turizm, industri etj. Krahas ndikimit në pellgun përkatës ujëmbledhës, ndotja e ujërave paraqet rrezik edhe për bregdetin dhe lagunat bregdetare. Cilësia e ulët e ujërave paraqet rrezik në radhë të parë për vetë shëndetin e njeriut. Gjithashtu, cilësia e ulët shkakton varfërimin e vlerave natyrore dhe turistike të zonës bregdetare, me pasoja edhe në zhvillimin e vendit. Si vend i pasur me vlera natyrore qoftë në brendësi, qoftë në bregdet, Shqipëria nuk mund të vazhdojë përjetësisht të kërkojë vetëm të përfitojë prej tyre, pa u

përpjekur për mbrojtjen, ripërtëritjen dhe rritjen e jetëgjatësisë së tyre edhe për brezat e ardhshëm.

Si masë e parë do të ishte kanalizimi, grumbullimi i rregullt i mbeturinave urbane qoftë të lëngëta qoftë të ngurta, fillimi i përpunimit, qoftë edhe pjesërisht, të shkarkimeve, sidomos në zona të tilla të banuara, si Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Fieri. Tirana, Kryeqyteti i vendit, i cili po pëson transformime rrënjësore në vitet e fundit, nuk mund të vazhdojë me dy kolektorë kryesorë ujërash të zeza që e përshkojnë atë mospërmas, Lana dhe Tirana, që vetëm me ironi mund të quhen lumenj. Të dhëna si ato të Lanës dhe Ishmit, dhe pamje si ato që shihen sot në brigjet e tyre është vështirë t'i gjesh gjetkë në Evropë, edhe në skajet më të humbura të saj. Padyshim, kjo gjendje është pasqyrim i një niveli të ulët përgjegjësie në gjithë nivelet e shoqërisë shqiptare, që nga individit i thjeshtë e deri tek organizmat qeveritare dhe joqeveritare të krijuara prej tij.

Vlerat e larta të lëndëve pezull gati në gjithë lumenjtë tregojnë për dëmtime serioze të mbulesës bimore në gjithë zonat kodrinore dhe malore. Kjo kërkon masa të menjëhershme në ripërtëritjen e pyjeve dhe shkurretave mesdhetare. Programet e pyllëzimit duhet të jenë me përparësi në rrugën e zhvillimit; prerja e pyjeve, kullotja e tepruar, sidomos prej dhive, dhe djegiet duhet të shqetësojnë jo vetëm institucionet përgjegjëse, por të gjithë shoqërinë shqiptare. Përpjekjet për të fituar mbi erozionin e madh të tokës janë e vetmja mundësi për ripërtëritjen e peisazheve natyrore dhe fuqisë tërheqëse dhe shlodhëse të tyre.

Duke patur parasysh rëndësinë e ujërave për zhvillimin e vendit, si dhe rreziqet që i kërcënojnë, mbetet gjithnjë domosdoshmëri vlerësimi i gjendjes natyrore dhe biodiversitetit të habitateve ujore, vlerësimi i shqetësimeve, i burimit dhe shkallës së ndotjes. Shumë probleme të ndotjes nuk vihen re menjëherë, por vetëm kur ato bëhen të dukshme dhe të matshme; por edhe më shumë kohë kalon deri sa të merren masat e duhura për parandalimin ose zhdukjen e dëmtimeve.

E quajmë me shumë përparësi krijimin e një rrjeti efikas monitorimi për ujërat sipërfaqësorë në Shqipëri, duke përfshirë dhe biomonitorimin. Për më tepër, fushat e ekspertëve duhet të zgjerohen duke përfshirë,

mikrobiologë dhe kimistë organikë. Ky zhvillim do të forcojë grupet monitoruese në institucionet shqiptare. Ministria e Mjedisit dhe institucionet e tjera përgjegjës do të kenë më shumë informacion për gjendjen mjedisore; kjo do të rrisë përgjegjësinë për t'i ruajtur dhe mirë administruar ato; monitorimi efikas ndihmon edhe në rritjen dhe ndërgjegjësimin publik, i cili mbetet ende embrional, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ujit, trajtimit të mbetjeve dhe përgjegjësinë për përdorimin e ujërave.

Lumenjtë shqiptarë janë ushqyesit kryesorë të Adriatikut Lindor. Pas prurjeve të lumit Po në Italinë e Veriut, Shqipëria mund të konsiderohet si furnizuesja kryesore me ujë e gjithë Detit Adriatik. Ligatinat bregdetare shqiptare janë mjaft të rëndësishme për strehimin, riprodhimin e shumë gjallesave ujore (si peshq, moluskë, shpend ujorë etj.), jo vetëm për Shqipërinë, por për gjithë hapësirën adriatike. Për këtë arsye, ruajtja e cilësisë së ujërave dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pellgjeve ujëmbledhës do të përmbushë edhe përgjegjësitë e Shqipërisë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit (AKM/NEA, 1999) është aprovuar qysh në vitin 2000. Prej vitit 1991, Shqipëria është palë e më shumë se 13 konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve mjedisore. Këto akte të rëndësishme janë shpresëdhënëse për masa efektive në të ardhmen. Duke marrë masat e duhura në pellgjet ujëmbledhës më të rëndësishëm dhe më të ndjeshëm, padyshim mund të ripërtërihet cilësia e ujërave edhe bukurina e humbur e peisazheve lumore. Kjo jo vetëm se do të rrisë sigurinë e shëndetit të njeriut dhe botës së gjallë, por do të rrisë edhe përfitimet e shoqërisë shqiptare në rrugën e zhvillimit dhe të qytetërimit.